



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-060/01-001/547/26
Data.
Data. 31.03.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skendraj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë së Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

T H Ě R R E T

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 07.04.2026, (ditë e marte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara,
4. Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.09-020/01-0010900/26, i datës; 26.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve për muajin janar 2026, dëme të shkaktuara në bujqësi, ekonomi familjare, biznese dhe vetura në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale 532,666.96 Euro,(raporton Kryetari i Komisionit z. Hajzer Shala),
5. Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë publike si pasojë e vërshimeve të muajit janar 2026, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale 2,014,930.00 Euro,(raporton Kryesuesja e Komisionit znj. Sanije Ahmeti),
6. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01-020/01-008208/26, të datës; 03.03.2026, të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderaj të datës; 27.02.2026, përkitazi me procedurën e formimit të komitetit për politik dhe financa,(raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija),
7. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.


KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu-Alija

Adelina Spahiu-Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i **MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,**
i datës **27.02.2026,** ora **10:00**

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara,
4. Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Regjionale të Mbeturinave Uniteti SH.A Mitrovicë, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
5. Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale Eko –Natyra SH.A, Skenderaj,(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
6. Propozim-vendim për zgjedhjen e përfaqësues të Komunës se Skenderajt për Asociacion të Komunave të Kosovës,(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
7. Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
8. Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Procesin e Zgjedhjes se Këshillave të Fshatrave, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
9. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020.01-0004914/26 i datës; 03.02.2026, për Formimin e Komitetit për Politik dhe Financa. (raporton Kryesuesja e Kuvendit znj Adelina Spahiu Alija).
10. Propozim – vendim për iniciimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës se Skenderaj për vitin 2026-20234,(raporton drejtori i urbanizmit z. Arbnor Citaku).
11. Pyetjet e këshilltarëve nën pikën të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : I nderuar Kryetar i komunës z. Sami Lushtaku, të nderuar anëtar të kuvendit, dhe gjithë ju të pranishëm, para se te fillojmë me rend dite, nesër me 28 shkurt, bëhen 28 vite nga beteja e Çirezit dhe Likoshanit, ne nderim te Dëshmoreve dhe Martireve te kësaj beteje, ju ftoj një minutë nderim, Lavdi.

Të pranishëm në sallë janë 25 anëtarë anëtarë të Kuvendit, gjatë seancës bashkëngjiten Feriz Shala dhe Donika Mustafa, vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap diskutimin, pasi që nuk ka për diskutim, shkojmë me votim, konstatojmë se me 23 vota për asnjë kundër , 3 abstenime miratohet rendit i ditës, vazhdojmë me pikën e 3 shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap diskutimin, pasi qe nuk ka për diskutim, shkojmë me votim, konstatojmë se me 25 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar, vazhdojmë me pikën e radhës Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Regjionale të Mbeturinave Uniteti SH.A Mitrovicë, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).

Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, të nderuar përfaqësues te OSBE-së, shoqërisë civile, ju anëtar te Kuvendit, ne rënd dite kemi

formimin e komisioneve komunale te ndërmarrjeve, ne këtë raste Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Regjionale të Mbeturinave Uniteti SH.A Mitrovicë, propozoj formimin e komisionit prej 3 anëtareve, 1 anëtar i propozuar nga Kryetari ne këtë rast nga unë qe do ia sjelli sekretarisë propozimin për vendim si dhe 2 anëtar nga Kuvendi, kërkoj nga grupet politike ti japni dy propozime.

Alban Berisha PDK- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë krahas propozimit te Kryetarit edhe ne si grup parlamentar i PDK-së kemi dy emra për anëtar te komisionit te aksionarëve të Uniteti, Burim Veliu dhe Sefer Bajraktari, faleminderit,

Nezir Bejta, LVV- Faleminderit, përshëndetje për të gjithë, për këtë komision propozoj Floriana Halili.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija – Faleminderit për propozimet, një sqarim shtesë për propozimet te ekzekutivit, emrin nga ekzekutivi do ta sjellë Kryetari ne sekretari për vendim, me qenë se i kemi 3 propozimet na u duhet ti kalojmë ne votim një nga një, propozimi i parë Burim Veliu, votojmë kush është për, kush është kundër, abstenim, shkojmë me propozimin e dytë Sefer Bajraktari, kush është për, kundër abstenim, kush është për propozimin e 3 Floriana Halili, kush është për, kundër abstenim, Atëherë Burim Veliu ka marr 21 vota për 0 kundër dhe 4 abstenime, Sefer Bajraktari 21 për 0 kundër dhe 4 abstenime, Floriana Halili 3 për 21 kundër 1 abstenim, atëherë Burim Veliu dhe Sefer Bajraktari marrin votat e mjaftueshme për te qenë pjesë e komisionit te aksionareve te ndërmarrjes regjionale te mbeturinave unitetit, është procedurë e votimit si tërësi propozim vendimi te votohet, konstatojmë se me 21 vota për 3 kundër dhe 1 abstenim miratohet Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Regjionale të Mbeturinave Uniteti SH.A Mitrovicë, vazhdojmë me pikën e 5 të rendit të ditës, Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale Eko –Natyra SH.A, Skenderaj,(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).

Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku –Faleminderit Kryesuese, ne rënd dite kemi formimin e komisioneve komunale te ndërmarrjeve, ne këtë raste Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale Eko – Natyra Skenderaj , propozoj formimin e komisionit prej 3 anëtareve, 1 anëtar i propozuar nga Kryetari ne këtë rast nga unë qe do ia sjelli sekretarisë propozimin për vendim si dhe 2 anëtar nga Kuvendi, kërkoj nga grupet politike ti japni dy propozime.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija – Faleminderit Kryetar, e hap diskutimin për propozime.

Alban Berisha PDK- Faleminderit Kryesuese, si grup parlamentar i PDK-së, japim këto propozime për anëtarë ne komisionin e aksionareve për ndërmarrjen publike lokale Eko – Natyra Skenderaj, Ervin Rexhepi dhe Abdullah Gashi.

Nezir Bejta, LVV- Faleminderit, për këtë komision propozoj Floriana Halili.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Me qenë se i kemi 3 propozimet na u duhet ti kalojmë ne votim një nga një, propozimi i parë Ervin Rexhepi, votojmë kush është për, kush është kundër, abstenim, shkojmë me propozimin e dytë Abdullah Gashi , kush është për, kundër abstenim, kush është për propozimin e 3 Floriana Halili, kush është për, kundër abstenim, Atëherë Ervin Rexhepi ka marr 21 vota për 0 kundër dhe 3 abstenime, Abdullah Gashi 21 për 0 kundër dhe 1 abstenim, Floriana Halili 3 për 21 kundër 1 abstenim, atëherë Ervin Rexhepi dhe Abdullah Gashi marrin votat e mjaftueshme për te qenë pjesë e komisionit te aksionareve te ndërmarrjes publike lokale Eko - Natyra, Skenderaj, vazhdojmë me pikën e 6 të rendit të ditës, Propozim-vendim për zgjedhjen e përfaqësuese të Komunës se Skenderajt për Asociacion të Komunave të Kosovës,(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku

Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku – Faleminderit Kryesuese, ky propozim ka të bëjë me asociacionin e komunave ne te cilin një përfaqësues është Kryetari i Komunës ne këtë raste unë si dhe dy anëtar nga Kuvendi, ju kërkoj qe ti jepni propozimet.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Faleminderit Kryetar, vazhdojmë me propozimet.

Alban Berisha PDK- Faleminderit Kryesuese, për asociacion të Komunave krahas përfaqësuesit nga ekzekutivi, nga grupi parlamentar i PDK-së, propozojmë Dardan Shala dhe Avdullah Geci.

Nezir Bejta, LVV- Për këtë komision propozoj Hysni Mehani.

Hysni Mehani, LVV – Kjo qe po ndodh është e pa parunshme mos përfshirja e opozitës ne asnjë komision për te cilën do të ankoj në MAPL e ju grahni.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Pasi qe edhe këtu i kemi 3 propozime, shkojmë ne votim një nga një, votojmë për propozimin e parë Dardan Shala, kush është për, kundër abstenim, propozimin e dytë Avdullah Geci, kush është për, kundër abstenim, shkojmë me propozimin e trete Hysni Mehani kush është për, kundër, abstenim, atëherë Dardan Shala merr 21 vota për 2 kundër dhe 1 abstenim, Avdullah Geci merr 21 për, 3 kundër dhe 1 abstenim, dhe Hysni Mehani 3 për, 21 kundër dhe 1 abstenim, atëherë Dardan Shala dhe Avdullah Geci marrin votat e mjaftueshme për te qenë pjesë e asociacionit të Komunave, shkojmë ne votim ne tërësi te Propozim-vendim për zgjedhjen e përfaqësuese të Komunës se Skenderajt për Asociacion të Komunave të Kosovës, konstatojmë se me 21 vota për 3 kundër dhe 1 abstenim miratohet propozim vendimi për asociacion te Komunave, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).

Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku –Kryesuese, propozimi i radhës është për zgjedhjen e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale te fshatrave, komision qe do te përbehet nga 4 anëtar nga Kuvendi, 1 anëtar ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 anëtar nga vendbanimi, lokaliteti, nga ekzekutivi do e përcjellim emrin ne sekretari për vendim, kërkoj nga Kuvendit ti japni propozimet.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Faleminderit Kryetar, e hapi diskutimin, kërkoj ti jepni propozimet për komision.

Fikret Rexhepi, PDK – Faleminderit Kryesuese, i nderuar Kryetar, për këtë komision propozoj Alban Berisha.

Nezir Bejta, LVV- Faleminderit Kryesuese, pasi qe nuk kaluan propozimet qe i dhashë me herët, po e propozoj veten tash.

Hisni Avdullahi, Iniciativë Qytetare – Faleminderit, propozoj Afrim Kabashi.

Afrim Kabashi, NSD – Unë propozoj Hisni Avdullahi.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Atëherë shkojmë ne votim, me propozimet e marra, konstatojmë se me 25 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet propozim – vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave te fshatrave bashkë me propozimin qe do ta sjellë Kryetari ne Sekretari për vendim, vazhdojmë me pikën e 8 të radhës Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Procesin e Zgjedhjes se Këshillave të Fshatrave, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).

Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku – Pika e 8 e rendit te ditës ka te beje me formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave ne procesin e zgjedhjes se këshillave të Fshatrave, komision qe do të përbehet nga 3 anëtarë nga Kuvendi, ju kërkoj qe ti jepni propozimet.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - E hap diskutimin.

Alban Berisha, PDK –Faleminderit Kryesuese, nga grupi parlamentar i PDK-së, për këtë komision propozoj Arlinda Haliti dhe Ferdane Beqiri – Emimi.

Afrim Kabashi, NSD- Faleminderit Kryesuese për këtë komision propozoj Feriz Shala.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Atëherë shkojmë ne votim për këtë propozim, konstatojmë se me 22 për, 0 kundër dhe 3 abstenim miratohet Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Procesin e Zgjedhjes së Këshillave të Fshatrave, vazhdojmë me pikë 9 të radhës Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020.01-0004914/26 i datës; 03.02.2026, për Formimin e Komitetit për Politik dhe Financa. (raporton Kryesuesja e Kuvendit znj Adelina Spahiu Alija), propozimi ne fjale ka te beje me rishqyrtimin e vendimit për formimin e komitetit për politik dhe financa i miratuar ne seancën e kuvendit të datës 30.01.2026, bazuar ne rekomandimin e MAPL-së për rishqyrtim qe kërkohet anëtarja Floriana Halili te zëvendësohet me një anëtar nga i njëjti subjekt politik duke e ruajtur përfaqësimin politik ne komitet, e hap diskutimin për këtë pikë të rëndit të ditës.

Nezir Bejta, LVV- Faleminderit Kryesuese puna e këtij komisioni është bërë si ura e shenjet dikush natën po e rrënon, shpresoj kësaj radhe te rregullohet, ne prapë e kemi te njëjtin propozim Hysni Mehani.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Atëherë shkojmë me votim, konstatojmë se me 20 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim miratohet Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020.01-0004914/26 i datës; 03.02.2026, për Formimin e Komitetit për Politik dhe Financa, vazhdojmë me pikën e 10 të rëndit të ditës, Propozim – vendim për iniciimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Skenderaj për vitin 2026-20234,(raporton drejtori i urbanizmit z. Arbnor Citaku).

Arbnor Çitaku, DUMA – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, propozim – vendim për miratimin e vendimit për iniciimin e procedurës së hartimit të planit zhvillimor komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034, ky plan përfshin zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën 8 vjeçare, ky plan ka kaluar periudhën 8 vjeçare me 31.12.2025, planin do ta hartoj një kompani profesionale ne bashkëpunim me ekspertet e fushës me pas do te kaloj fazën e diskutimit publik dhe për miratim ne kuvend, ju ftoj qe ta përkrahni këtë propozim vendim.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija - Faleminderit drejtor, e hapi diskutimin

Hysni Mehani, LVV –Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, e di drejtor si je rishto ne këtë pozitë, ne qeverisje lokale është problem me procedu ne këtë formë po don me inicu PZHK po nuk po i ke te kjartha kompetencat, këtu ne propozim është cek neni 58 për kompetenca te Kryetarit qe thotë propozon rregullore apo akte tjera për miratim ne Kuvend, nuk është kompetencë e drejtorit ne këtë rast, është problem se si e ke inicu sepse është dashtë te vije nga Kryetari ky propozim, nuk mundet drejtori i drejtorisë me inicu rregullore, tjetër kpf duhet ti trajtoj këto çështje e pastaj te vijën ne Kuvend.

Arbnor Çitaku, DUMA- Hysi ky është vetëm fillimi i procedurës, pastaj do te vije edhe për miratim këtu në Kuvend.

Hysni Mehani, LVV – Ne parim është ne rregull është inicim, po qiky inicim duhet me ardhë nga Kryetari, e tregoni mua se neni 62 cila pik ja mundëson drejtorit me inicu procedu, Mapl-ja do ua kthen te jashtëligjshëm.

Rrezarta Hasani – Ibrahim, PDK- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, sa i përket PZHK-së konsideroj se ky dokument është e nevojshme te jete ne harmoni me legjislacionin ne fuqi, dhe me standartet ligjore ne mënyrë qe ti shmangeni paqartësive juridike, pastaj tek neni 4 i propozimit kam një vërejtje tek kontraktimi i kompanisë hartuese te planit, kompetencë e zhvillimit te procedurave është prokurimi publik e jo Duma, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija -Atëherë shkojmë me votim, konstatojmë se me 21 vota për, 3 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – vendim për iniciimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Skenderaj për vitin 2026-20234, vazhdojmë me pikën e 12 Pyetjet e këshilltarëve nën pikën të ndryshme.

Vlora Jashari, PDK- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, po i lexoj pyetjet e parashtruara, 1. Çfarë hapa konkretë ka ndërmarrë Komuna e Skenderajt për krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë? 2. A ka komuna një plan të strukturuar për dokumentimin, arkivimin dhe botimin e historisë së Skenderajt (dëshmi, fotografi, dokumente, kujtime), dhe pse deri më tani kjo fushë është lënë kryesisht në iniciativë individuale? 3. A ka Komuna e Skenderajt ndonjë strategji konkrete për mbajtjen e fermerëve të rinj në bujqësi? si dhe një pyetje shtesë shqetësim i qytetarëve lidhur me funksionimin e barnatoreve kujdestare disa prej tyre nuk po janë hapur gjate kujdestarisë

Kosovare Ahmetaj, DKRS - Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, në kuadër të DKRS-së e kemi arkivin për mbrojtjen dhe ruajtjen e lëndëve arkivore ka dokumente dhe të dhëna që nga viti 1945, arkivi që shërben si pikë referuese për studiuese, nxënës dhe student që shërben për hulumtim, arkivi është i hapur çdo ditë pune nga ora 08; 16, që mund të shërbehen të gjithë.

Besarta Meha, DZHENIT – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, sa i përket politikave për punësimin e të rinjëve në si Komunë në kuadër të drejtorisë kemi mbështetur 100 të rinjë kanë përfutur nga projektet tona në punë praktike me pagës, e disa prej tyre kanë fituar vende pune nga këto projekte, si dhe kemi përkrah projekte të ndryshme rinore me grande dhe subvencione.

Hasan Hoti, DSHMS – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, sa i përket barnatoreve kujdestare, në si drejtori në fund të çdo muaji e bëjmë orarin e kujdestarisë që ua përcjellim barnatoreve, çdo barnatore obligohet ta vendos orarin e shërbimit të saj, ndërsa inspektorati e përcjell funksionimin e tyre.

Afrim Kabashi, NSD- Faleminderit Kryesuese, fillimisht një kompliment për drejtorin e shëndetësisë që e kemi përkrah një rast të Polacit, 1. A pritet në vazhdimin e punimeve në projektin ndriçimi publik nëpër fshatra, projekt i lënë në gjysmë të realizimit si në disa lagje të fshatit Polac. 2. Për drejtorin e arsimit, drejtor a pritet për fillimin e punimeve për ndërtimin e çerdhës fëmijëve në fshatin Polac, projekt i premtuar nga mandati i kaluar. 3. Për urbanizmin a pritet vazhdimi i projektit kyqjet individuale dhe kur pritet të këtë ujë për pije nga rrjeti i ujësjellësit për banoret e Fshatit Makerrmal.

Arber Geci DSHP – Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pyetjes së Afrimit rreth projektit të ndriçimit, kemi filluar me këtë projekt, kompania bashke me menaxher të projektit janë në teren, me përmirësim të kohës do realizohet mirë ky projekt.

Kastriot Duraku, DKA- Sa i përket çerdhës në Polac, është projekt i Ministrisë po besoj këte vite do të përfundoj.

Arbnor Çitaku, DUMA- Fshati Makerrmal lidhet me ujësjellësin e Rezalles, është shpërnda deri në Rezall, e do vazhdon edhe në Makerrmal me kycje.

Afrim Kabashi, NSD- Drejtor tregona lokacionin e çerdhës në Polac.

Kastriot Duraku, DKA- Lokacioni i çerdhës është afër shkollës fillore të Polacit.

Kushtrim Dragaj, PDK – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, po i paraqes pyetjet e mia rreth rrugës Llaushë – Skenderaj, pas reshjeve të fundit në rrugën Llaushë, Skenderaj tek prroi i keq uji ka bartur zhavorr kah skaji i rrugës si pasojë e kësaj ka pasur aksidente në atë pjesë, është e nevojshme të ndërmerrni masa në atë pjesë, I nderuar Drejtor i Gjeodezisë, Me datë 08 prill 2026 bëhen dy (2) vite nga vendosja e gurthemelit të xhamisë së re pranë Shkollës Profesionale,

në parcelën e ndarë nga Komuna e Skenderajt për Bashkësinë Islame të Kosovës – Dega Skenderaj. Kërkesa e Bashkësisë Islame është e protokolluar në Komunë dhe projekti është i përfunduar në letër, i gatshëm për aplikim për leje ndërtimore. Po ashtu, ju njoftoj se donatori ka qenë i lajmëruar që nga fillimi për realizimin e këtij projekti. Andaj, kërkoj nga ju që kjo çështje të procedohet pa vonesa dhe, në mundësinë e parë ligjore, të silltet në Kuvend Komunal për dhënie në shfrytëzim dhe votim, në përputhje me ligjet në fuqi. Kërkoj veprime konkrete dhe mosneglizhencë, duke pasur parasysh rëndësinë publike dhe interesin qytetar të këtij projekti

Arbnor Çitaku, DUMA- Kushtrim kërkesa të tilla ka të shpeshta, sot e kemi diskutuar me kompanin atë problem shumë shpejt do ta zgjidhim atë problem.

Granit Musliu, DGJKP- Sa i përket dhënies së pronës për Xhami, vitin e kaluar ka pasur zgjedhje parlamentare e lokale, e ligji e ndalon në atë fazë me jap pronë në shfrytëzim, prandaj për këtë arsye nuk ka qene e mundur, tash kemi procedu listën e pronave për dhënie në shfrytëzim, e që do të trajtojmë të gjitha lëndet, edhe kësaj çështje do të bëjmë zgjidhje.

Nezir Bejta, LVV- Faleminderit Kryesuese, po i lexoj pyetjet e parashtruara për këtë seance, Pyetje për drejtorin e DKA-së, zotin Kastriot Duraku si asambletist i Kuvendit Komunal, ju drejtohem me disa pyetje që janë shqetësuese, jo vetëm për mua. Pyetja e parë ka të bëjë me rrjedhën e ujërave të zeza në oborrin e gjimnazit "Hamëz Jashari", që paraqet një rrezik permanent për shëndetin e nxënësve. Zoti Drejtor, a keni njohuri për rrjedhën e këtij uji dhe cili do të jetë veprimi juaj? Edhe pyetja tjetër ka të bëjë me gjimnazin, të cilit gjatë renovimit i është mbyllur njëra hyrje, duke shkaktuar kështu vështirësi në lëvizjen e nxënësve. Pyetja ime është: a do ta hapni hyrjen tjetër, ashtu siç ishte më parë, dhe a do të ketë shkallë emergjente për shkak të sigurisë së nxënësve, në rast të fatkeqësive natyrore? Pyetja e tretë ka të bëjë me SIIFMU "Rifat Mëziu", e cila u formua me bashkimin e dy shkollave, "Shaban Jashari" dhe "Ahmet Delia", nga klasa e 6 deri 9. Pyetja është: cila ishte arsyeja që e zgjodhet këtë model, pasi që shumë pak shkolla e praktikojnë në Kosovë?

Kastriot Duraku, DKA- Sa i përket pyetjes për ujera të zeza, atë është problemi me gyp të ujës-jellësit e jo ujera të zeza, ku ne i kemi njoftuar ujës-jellësit kanë intervenuar mirëpo prape ka rrjedhe të ujit të pijshëm e që prape do të njoftojmë, për shkallë emergjente kemi pasur problem me buxhet mirëpo këtë vite do të rregullojmë, sa i përket bashkimit të shkollave është bere për shkak se të dy shkollat kanë pasur numër të sterngarkuar të nxënësve dhe nuk jemi Komuna e vetme se i kemi bashku, kur kame dërgua kërkesën në Ministri kemi qenë të 109, domethënë edhe shume Komuna kanë vepruar kështu.

Nezir Bejta, LVV- Tash është ngarkuar edhe Shkolla Rifat Mziu, me rreth 30 deri 35 nxënës me një klasë, domethënë është dashur me herët të behet një analize ndonjë komision profesional me mëndu me afat gjate për këtë çështje.

Kastriot Duraku, DKA- Shkolla Fillore Shaban Jashari ka pasur numër të madh të nxënësve diku 1500-1600, me shume se Shkolla Rifat Mziu, vitin e ardhshëm mendojmë me hap paralele të reja në atë Shkollë.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija Pasi veç i trajtuam të gjitha pikat e rendit të ditës, e konsideroj të mbyllur këtë seancë.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSAMBLI OF MUNICIPALITY / SKUPSTINA BLSIA
SHKENDERAJ

Nr. 02-052/01-0011447/26
Data 30.03.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, parag. 2, nënparagra. 2.2, nenit 12 parag.1, nënparagrafi 1.5 dhe 1.6, neni 31, paragra. 1, nënparagra. 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, dhe nenin 50,1 nën h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të dt.03.12.2008, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të datës ____ 2026, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

- I. Miratimin e Raportit Përfundimtar Nr. 09-020/01-0010900/26, të datës 26.03.2026, i hartuar nga Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e vërshimeve për muajin Janar 2026. Dëme janë shkaktuar në bujqësi, ekonomi familjare, biznese dhe vetura në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej **532,666.96 Euro**.
- II. Raporti i dëmeve i cekur në pikën I, i shqyrtuar nga Kryetari i Komunës, përmban një vlerësim profesional më të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim nga komisioni i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe të kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët (familjet) të dëmtuar nga vërshimet, dhe i njëjti raport pas miratimit në Kuvendin Komunal dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL, i dorëzohet Agjencisë së Menaxhimit Emergjent dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Bashkëngjitur: Raporti Nr. 09-020/01-0010900/26, të datës 26.03.2026, Lista e dëmeve të ekonomive familjare të vlerësuara nga Komisioni Komunal, Lista e fermerëve të vlerësuar nga Komisioni Komunal, Lista e dëmeve të bizneseve të vlerësuara nga Komisioni Komunal, dhe vendimi bazë i Komisionit Komunal Nr. 02-020/01-0000931/26, të datës 08.01.2026 i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr.02-020/01-0004062/26, të datës 28.01.2026.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES / РЕСПУБЛИКА КОСОВО
KOMUNA E SKENDERAJT / КОМУНАЛИТЕТИ ШКЕНДЕРАЈ
DREJTORIA PËR SHËRBYME PUBLIKE
No: 09 - 020/09-2010900/26
Data: 26 03 2026



Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Shërbime Publike
Direkçija za Javne Službe
Department for Public Services

DATE:	26.03.2026
PËR:	Zyrën Ligjore, Kuvendin Komunal
PËRMES:	Drejtori i D.SH.P, Arbër Geci
NGA:	Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera: 1. Hajzer Shala Kryesues 2. Hetem Dajaku Anëtar 3. Sabit Ferizi Anëtar 4. Faton Osmani Anëtar 5. Gentrit Hasani Anëtar
TEMA:	Raport përfundimtar i komisionit për vlerësimin e dëmeve, Janar 2026

Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, sipas Republikës (QRK)- Nr. 17/2015 për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe në baze të kërkesave të palëve të dëmtuara, pas përfundimit të vlerësimeve, komisioni ka bërë raportin përfundimtar në të cilin kanë konstatuar vlerën e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga vërshimet, zjarret dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar 2026.

Pas përfundimit të vlerësimeve, komisioni komunal ka bërë raportin përfundimtar, në të cilin raporton i ka konstatuar dëmet në ekonomi familjare, bujqësi, biznese dhe vetura si në tabelën në vijim:

Nr.	Kategoria	Nr. i rasteve	Vlera
1	Dëmet ne Ekonomi Familjare:	159	456.978.111
2	Dëmet e fermerëve në Bujqësi:	75	88.050.741
3	Dëmet në Biznese:	15	47.399.061
4	Dëmet në Vetura:	10	40.258.001
	TOTALI I DËMEVE:	259	532.686.914

Vlerësimin e dëmeve e zbatojnë drejtpërsëdrejti në zonën në të cilin kanë ndodhur dëmet, duke bërë grumbullimin e të dhënave lidhur me dëmet materiale dhe dokumentimin me fotografi. Përkundër kësaj, dëmet në të mirat materiale të dëmtuara bëhet në bazë të çmimeve përkatëse. Çmimet sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila bën përcjelljen e çmimeve, po ashtu çmimet nga tregu, çmimet nga ndërmarrjet që bëjnë furnizime të tilla.

Andaj propozoj që ky raport të hyje si pike e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal për miratim. Listat e përmbledhur e vlerësimi të dëmeve, pas miratimit nga Asambleja Komunale e Skenderajt do të dërgohet në Komisionin Qeveritar (AME) për vlerësimin e dëmeve për muajin Janar 2026.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY OF SKENDERAJ
SKENDERAJ

Nr. _____
No. 02-020/01-0000934/26
Data: _____
Data: 08.07.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13, 17 pika g) dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, ndërlidhur me nenin 90 parag.1, 2, dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenit 8 parag. 1 dhe 2 nënparag. 2.2 të Rregullores (QRK) Nr 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Kryetari i Komunës më datë 06.01.2026 miratonte këtë

VENDIM
(Për themelimin e komisionit)

- I. **Themelohet komisioni profesional me mandat katër (4) vjeçar, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në Komunën e Skenderajt, në këtë përbërje:**
 1. Hajzer Shala - DShP, kryesues;
 2. Dardan Smajli - DUMA, anëtar;
 3. Sabit Ferizi - DBPZhR, anëtar;
 4. Faton Osmani - DShP, anëtar;
 5. Gentrit Hasani - DShP, anëtar.
- II. Detyrë e komisionit është që të koordinojë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e shkaktuara në bazë të raporteve të mbledhura nga dalja në vend-shikim si dhe në bazë të kërkesave për kompensim nga qytetarët (ekumotatë familjare dhe bizneset), dhe më pas të përgatit raport profesional dhe të dorëzojë tek Kryetari i Komunës për procedurat e më tutjeshme.
- III. E tërë procedura, detyrat dhe metodologjia e vlerësimit të dëmeve që duhet ndjekur nga komisioni, është e përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e vendosura më parë me këtë çështje.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:


- Arkivit
- DShP-së
- Anëtarëve të komisionit

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës së DUMA-së Nr.06-020/01-0003834/26, të datës 26.01.202 duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Nr.110-385 të datës 03.12.2008, merr këtë:

V E N D I M

- I. **Miratohet** ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit Nr.02-020/01-0000931/26, të datës 08.01.2026, për themelimin e komisionit profesional me mandat katër (4) vjeçar për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në Komunën e Skenderajt.
- II. Në nenin I të vendimit bazë, anëtari Dardan Smajli, **zëvendësohet** me anëtarin e ri z. **Hetem Dajaku**.
- III. Pjesa tjetër e Vendimit Nr.02-020/01-0000931/26, të datës 08.01.2026, mbetet e pandryshuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- Anëtarit





Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOCHVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-325/04-0011509126

Data 31.03.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 50,1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, dt.03.12.2008, nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 8, parag. 2, nënparagrafi 2.2, nenin 12 parag.1, nënparagrafi 1.5 dhe 1.6, nenin 31, parag. 1, nënparagrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të datës ____2026, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

- I. Miratimin e **Raportit Përfundimtar** Nr. 06-325/04-0011275/26, të datës 30.03.2026, i hartuar nga **Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara në Infrastrukturën Publike**, si pasojë e vërsimeve të muajit Janar 2026, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej **2, 014, 930.00 Euro**.
- II. Raporti i dëmeve i cekur në pikën I, i shqyrtuar nga Kryetari i Komunës, përmban një vlerësim profesional më të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim e komisionit të emëruar nga Kryetari i Komunës dhe të kërkesave nga qytetarët, dhe i njëjti raport pas miratimit në Kuvendin Komunal dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL, i dorëzohet Agjencisë së Menaxhimit Emergjent dhe një kopje të njejtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Bashkëngjitur: Raporti Nr. 06-325/04-0011275/26, të datës 30.03.2026, tabela e dëmeve në infrastrukturën publike, dhe vendimi për themelimin e Komisionit Komunal Nr. 02-020/01-0000935/26, i datës 08.01.2026.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0000935/26
Data.
Data. 08.07.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika g) dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Kryetari i Komunës më datë 06.01.2026 merr këtë:

V E N D I M
(Për themelimin e komisionit)

- I. **Themelohet komisioni profesional (ad hoc) për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën publike të Komunës së Skenderajt, si pasojë e vërshimeve të datës 06.01.2026, të shkaktuara nga reshjet e shiut, në këtë përbërje:**
 1. Sanije Ahmeti, kryesuese;
 2. Adem Muharremi, anëtar;
 3. Visar Hyseni, anëtar;
- II. Detyrë e komisionit është që të koordinojë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për evidentimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën publike dhe të bëjë vlerësimin e dëmeve në bazë të raporteve të mbledhura nga dalja në vend-shikim, dhe më pas të përgatit raport profesional dhe ta dorëzojë tek Kryetari i Komunës për procedurat e mëtutjeshme.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DUMA-së
- Anëtarëve të komisionit

Kryetari i Komunës


Sami Lushitaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/OPŠTINA OPSINA
SKENDERAJ

Nr. No. 06-325/04-00/1275/26
Data Date 30.03.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambiena
Department of Urban and Environmental Protection


DATË/A:	23.03.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kryetarit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorisë për Urbanizëm
NGA/OD/FROM:	Komisioni i vlerësimit: Sanije Ahmeti Adem Muharremi Visar Hyseni
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në infrastrukturën publike të Komunës



Duke u bazuar në kërkesën me nr.06-350/02-0052805/25 të datës 18.12.2025 për formimin e komisionit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën publike të Komunës së Skenderajt, si pasojë e vërshimeve të datës 06.01.2026, të shkaktuara nga reshjet e shiut, komisioni bëri vlerësimin sipas kërkesave dhe gjendjes në teren të: rrugëve, lumenjeve, kanalizim, shteg qiklizmi etj.

Ku nga parashtrimet e kërkesave nga qytetarët dhe verifikimi gjendjes nga terreni komisioni formoi listen tabelare përfshirë të gjitha kërkesat e qytetarve të verifikuara sipas gjendjes në teren-ku vlera totale e dëmeve arrin vlerën rreth 2,014,930.00€.

Më respekt !



DREJTORIA PER URBANIZEM DHE MBROJTJE TE AMBIENTIT - SKENDERAJ
 Skenderaj, me 23.03.2026

Për : Zyren e Kryetarit

Nga : Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit


Nr.	Emëri i kërkesës	Vendi	faqe	Kërkesa	Skenim	Vlera €
1	Shtrati Lumi Klina zona urbane	Lumi Klina		Dëmtimi i shtratit të lumit	Rregullimi i shtratit të lumit klina me infrastrukturën perçjellose L=3300.0m	880,000.00
2	Shtegu qkllistave ne skaj lumit Klina qender urbane	segmenti ne afersi parkut "Idriz Rreçi"		Dëmtimi i shtegut të ri ne afersi parkut "Idriz Rreçi" Skenderaj	Rregullimi i shtegut nga asfalti dhe kubzat L=600m	37,500.00
3	Lumenjtet ne teritorin e Komunes	rrjedhat e Lumenjeve dhe pirockave		Degradimi i rrjedhave të lumenjeve nga erodimi dhe mbushjet materialeve inerte	Patrimi dhe rregullimi i rrjedhave te lumenjeve	700,000.00
4		rr. Halit Ramaj Izbiçe		Rruga dhe ura e demtuar	Rregullimi i rruges L=170m dhe asfaltimi	15,000.00
5		Kline e Eperme		Rruge e demtuar	Punimi i murit mbrojtës BA ne gjatesi L=40m dhe H=5.0m	51,000.00
6		Vajnik		Urat ne Ozdrim dhe Turjan	Punimi i Murit mbrojtës BA ne gjatesi L=40m dhe H=5.0m	27,000.00
7		rr. Sađik Haziraj-Llaushë		Muri mbrojtës dhe kanalizimi	Punimi i Murit mbrojtës BA ne gjatesi L=60m dhe H=4.0m	31,500.00
8		Prekaz e Eperm		Ura e pakalueshme	Punimi i leshes plakore L=5m	15,000.00
9		Baks		Rruga e demtuar	Sanimi i leshes gypore dhe rruges se asfaltuar	1,250.00
10		Kuqice		Ara e demtuar	Pastrimi i ares nga zhavori i grumbulluar, me eskavator	450.00
11		rr. Hietem Zëjullahu-Llaushë		Rruga e demtuar	Rregullimi i rruges L=370m dhe asfaltimi	26,000.00
12		rr. Hoxha dhe Kaçkini-Skenderaj		Rruga e demtuar+I.eshesa	Rregullimi i pllakes BA pusesites se elektrikes dhe sanimi i rruges	400.00
13		rr. Faik Konica-Kline e Mesme		Rruga e demtuar	Rregullimi i rruges L=170m dhe asfaltimi	13,000.00
14		rr. Bahir dhe Sali Kajtazi-Kline M		Shtrati i prroit i demtuar	Pastrimi i kanalit L=100m nga zhavori i grumbulluar, me eskavator	450.00
15		rr. Haxhi Selimi-Kuqice		Muri mbrojtës	Punimi i Murit mbrojtës BA ne gjatesi L=52m dhe H=4.0m	35,000.00
16		Kllodernice		Ura e pakalueshme	Sanimi i leshes gypore dhe rruges	2,500.00
17		rr. Bislim e Hashim Lushaku-Sken.		Rruga dhe ura e demtuar	Rregullimi i rruges me te gjith infrastrukturën L=225.0m	22,000.00
18		Te kulla Ismet Rrahmani-Aqarev		Rruga e demtuar	Rregullimi i rruges L=500m dhe asfaltimi	45,000.00
19	Lagia HaxhiSylt	Kolliq i Positem		Ura e demtuar	Punimi i ures metalike per kembesor	5,000.00
20		Skenderaj		Rruga dhe obori demtuar	Rregullimi i rruges L=80m	6,500.00
21	Mirusha Company	Kline		Material per nderim, gjate nderimit te ures ne Llaushë	Kompenzimi i materialeve per nderim si: shylla metalike, pahi etj.	7,830.00
22		rr. Haxhi Imeni-Triqefic		Dëmtimi i rruges	Rregullimi i rruges L=450m	33,000.00



23	[REDACTED]	Klline e Epërme	[REDACTED]	Demitimi i kanalit atmosferik	Punimi i kanalit atmosferik nga përmasi L=100m	2,500.00
24	[REDACTED]	Klline e Epërme	[REDACTED]	Demitimi i kanalit atmosferik		
25	[REDACTED]	rr.Pacit Dibrani- Ferrahtë	[REDACTED]	Nveshtitje e diturim mbrojtës	Punimi i Murit mbrojtës BA me gjatësi L=22m dhe H=2.0m	1,400.00
26	[REDACTED]	Kuçiçe	[REDACTED]	Pastrimi i ures nga zavori	Pastrimi i ures nga zavori i grumbulluar, me eskavator	650.00
27	[REDACTED]	Klline e Epërme	[REDACTED]	Demitimi sanitar atmosferik	Punimi i kanalit L=100m nga zavori i grumbulluar, me eskavator	450.00
28	[REDACTED]	Kuçiçe	[REDACTED]	Ura e kumbësorete e demtar	Punimi i ures instalike per kembësor	5,000.00
29	Lagja Lani Llaushe	Llaushe	[REDACTED]	Rruga dhe Murat i demtar	Punimi i murit mbrojtës BA L=50m dhe H=3m nga zavori	20,250.00
30	[REDACTED]	Lagja Kuqani-Qubrel	[REDACTED]	Pastrimi i Llaushe	Pastrimi i murit prej mbrojtësve H zavori dhe mbeturiave L=600m	6,500.00
31	[REDACTED]	Rezall e re	[REDACTED]	Demitimi i kraheve te ures	Punimi i Murit mbrojtës BA me gjatësi L=22m dhe H=3.0m	6,200.00
32	[REDACTED]	Llaushtë	[REDACTED]	Bilokim kanali kultures atmosferik	Punimi i kanalit L=200m nga zavori i grumbulluar, me eskavator	1,250.00
33	[REDACTED]	Tushilë	[REDACTED]	Demitimi i kanalizimit fekal	Rregullimi i kanalizimit fekal fi315 dhe zbllokimi i tij L=150m	3,000.00
34	[REDACTED]	Aqarëve	[REDACTED]	Demitime skaj ures	Sanimi i hyrje-daljeve te ures me zavor	1,550.00
35	[REDACTED]	Llaushtë	[REDACTED]	Demitime te kraheve te ures	Sanimi anesor i ures	2,500.00
36	[REDACTED]	Llaushtë	[REDACTED]	Demitimi i ures	Sanimi i ures familjare	5,500.00
Gjithsej:						2,014,930.00


Komisioni:

1. Sanije Ahmeti
2. Adem Muharremi
3. Visar Hyseni





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës / Skupstina Opštine / Municipal Assembly

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, duke u mbështetur në nenin 53 paragraf 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 12 paragraf 2 shkronja d) nenin 51 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragraf 2 dhe nenin 4, 5 dhe 6 paragraf 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, ndërlidhur me nenin 13 paragraf 1, nënparagraf 1.1, i Rregullores (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunave dhe neni 14 paragraf 1, 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të dt.03.12.2008, si dhe bazuar në Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-10/12, dt. 27.03.2026, në seancën e rregullt të datës _____, Kuvendit të Komunës i propozon për miratim këtë:

PROPOZIM

- I. Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit Komunal Nr. 01-020/01-0008208/26, të datës 03.03.2026. të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderajt të datës 27.02.2026, përkthazi me procedurën e formimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.
- II. Në nenin I të Vendimit bazë, njëri nga anëtarët e gjinisë mashkullore të zëvendësohet me një anëtarë të gjinisë femërore, për të siguruar kështu përfaqësim të barabartë gjinor në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 dhe Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-10/12, dt. 27.03.2026.
- III. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Kuvendit Komunal, të plotësohet / ndryshohet vendimi bazë nr. Nr.01-020.01-00004914/26, i datës 03.01.2026.
- IV. Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

- Arkivit
- Anëtarëve të KK-së

Kryesuesja e KK-së
Adelina Spahiu Alija
Adelina Spahiu Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 18.03.2026 VI-020-10/11
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendim Nr.01-020/01-0008208/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0004914/26 për formimin e komitetit për politike dhe financa

I miratuar më datë: 27.02.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.03.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026, ka miratuar vendimin Nr.01-020/01-0008208/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0004914/26 për formimin e komitetit për politike dhe financa.

Vendimi Nr.01-020/01-0008208/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0004914/26 për formimin e komitetit për politike dhe financa, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore si dhe me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Në nenin 6, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, parashihet se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë në pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.

Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse".


Ndërsa neni 5 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, përcakton se "Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi".

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Skenderajt duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në mbështetje të nenit 11 nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 3 paragrafi 2, neni 4 dhe 5 neni 6 paragrafi 4 neni 12 paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përhërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 i Rregullores (MAPL) Nr.02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunave, duke u bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/18, të datës 13.02.2026, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 27.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

(Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020.01-00004914/26 i datës; 03.02.2026,
për formimin e komitetit për politik dhe financa)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi Nr. 01-020/01-0006954/26, i datës 20.02.2026, Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020.01-00004914/26 i datës; 03.01.2026, për formimin e komitetit për politik dhe financa, për zëvendësimin e anëtares të Komitetit për politik dhe financa **znj. Floriana Halili**, nga subjekti politik (LVV),

Zëvendësohet me anëtarin **z.Hysni Mehani**, nga i njëjti subjekt Politik (LVV) duke e ruajtur përfaqësimin politik, bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/18, të datës 13.02.2026.

Neni 2

Mandati i anëtarit të zëvendësuar është i njëjtë me mandat të Kuvendit të Komunës.

Neni 3


Pjesët tjera të vendimit Nr. 01-020.01-00004914/26 i datës; 03.02.2026, mbesin në fuqi dhe të pa ndryshuara.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Anëtarëve të zëvendësuar,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Dosjes.



1. Pyetja ime e parë është për drejtorin e DSHP-së, z.Arbër Geci.

I nderuar drejtor, pyetja ime ka të bëjë me ndriçimin në rrugën “Azem Bejta”. Mungesa e ndriçimit si dhe mosfunksionimi i semaforëve në atë rrugë që sa herë po sjellë aksidente që fatkeqësisht po përfundojnë me fatalitet. Rastin më të freskët e kemi atë të datës 17 mars që për pasojë pati vdekjen e një këmbësori teksa po kalonte rrugën. E di që ndriçimi në këtë rrugë nuk është në kompetencë të komunës, por ajo që po më intereson është nëse e keni adresuar si kërkesë në ministrinë përkatëse që të ketë veprime konkrete në mënyrë që të parandalohen aksidentet, dhe qytetarëve që banojnë ose kalojnë nga ajo lagje t’u ofrohet siguria e nevojshme.

2. Pyetja ime e dytë është për drejtorin e DKA-së, z.Kastriot Duraku.

Drejtor, këto ditë nga disa nxënës të gjimnazit “Hamëz Jashari” kam pranuar një shqetësim. Kabineti për lëndët kimi dhe biologji si dhe kabineti i lëndës së fizikës janë ende pa banka dhe pa karriga, dhe kështu mbajtja e pjesës praktike të këtyre lëndëve po bëhet e pamundur, gjë që e lë të mangët mësimnxënien. E di që kontrata ka skaduar, por kur pritet që të keni një kontratë aktive, kur supozohet që kabinetet të pajisen me banka dhe karriga në mënyrë profesorët dhe nxënësit e kësaj shkolle të fillojnë ta zhvillojnë praktikën.

Faleminderit!

Arlinda Haliti - PDK

Pyetjet e këshilltarëve

Nga: Nezir Bejta - LVV

Për: ekzekutivin e komunës

1. Si e arsyejon ekzekutivi i komunës së Skenderajt lidhjen e një kontrate 35-vjeçare për ndërtimin e stacionit të autobusëve në tokën komunale, ku kompania private përfiton 70% të tarifave të operimit, ndërsa komuna vetëm 30%, pa marrë qira për tokën dhe pa përfituar asgjë nga lokalet e shumta brenda stacionit të autobusëve? A nuk e konsideron ekzekutivi se një marrëveshje e tillë e dëmton interesin publik dhe pronën komunale, dhe mbi çfarë analize financiare është marrë ky vendim?
2. Sipas llogaritjeve të komunës sa është përfitimi vjetor i komunës për dhënien e kësaj prone?

Drejtuar: Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Lënda: Kërkesë për intervenim në rregullimin e kanalizimit në fshatin Polac, lagjja Veliu dhe kryqëzimi pranë Xhamisë në rr. "Mulla Brahim Polaci"

I nderuar Drejtor,

Në cilësinë time si anëtar i Kuvendit Komunal të Skendrajt, njëkohësisht edhe banor i fshatit Polac, po ju drejtohem me këtë kërkesë bazuar në shqetësimet e vazhdueshme të banorëve të kësaj zone lidhur me problemet e kanalizimit.

Konkretisht, kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për rregullimin e sistemit të kanalizimit në lagjen Veliu, ku ujërat e zeza rrjedhin vazhdimisht mbi rrugë. Ky problem është i kahershëm dhe po shkakton shqetësim të madh për banorët, duke paraqitur njëkohësisht rrezik serioz për higjienën dhe shëndetin publik.

Po ashtu, shqetësuese mbetet edhe gjendja në kryqëzimin pranë Xhamisë në rrugën "Mulla Brahim Polaci", ku gjithashtu ka rrjedhje të kanalizimit mbi rrugë, duke përkeqësuar situatën për banorët dhe kalimtarët.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij problemi për komunitetin lokal, kërkoj që drejtoria përkatëse të realizojë një inspektim të gjendjes në terren dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për zgjidhjen sa më të shpejtë të tij.

Gjithashtu, ju lutem të na informoni nëse është planifikuar realizimi i këtij projekti, si dhe për afatet e mundshme të fillimit dhe përfundimit të rregullimit të kanalizimit në këtë pjesë, në mënyrë që banorët të kenë një pasqyrë të qartë për zgjidhjen e këtij problemi.

Drejtuar: Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Lënda: Kërkesë për ndërhyrje ndaj deponisë ilegale në lagjen Veliu

I nderuar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,

Dëshiroj të ju drejtohem lidhur me një shqetësim serioz të ngritur nga banorët e lagjes Veliu.

Në këtë zonë është krijuar një deponi ilegale, ku individë dhe kompani të ndryshme janë duke hedhur mbeturina në mënyrë të pakontrolluar. Po ashtu, kjo hapësirë më herët është shfrytëzuar nga fëmijët për aktivitete sportive, ku kanë luajtur futboll dhe volejball. Kjo situatë po shkakton ndotje të konsiderueshme të mjedisit, rrezik për shëndetin publik si dhe po cenon rëndë cilësinë e jetës së banorëve të asaj lagjeje.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij problemi, ju lus që të ndërmerrni masa urgjente për:

- Pastrimin e menjëhershëm të kësaj deponie ilegale;
- Identifikimin dhe ndëshkimin e personave dhe subjekteve përgjegjëse;
- Vendosjen e mekanizmave patandalues për të shmangur përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Jam i gatshëm të bashkëpunoj dhe të kontribuoj në çdo formë për zgjidhjen sa më të shpejtë të këtij problemi.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe pres angazhimin tuaj në këtë çështje

Drejtuar: Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Lënda: Propozim për lidhjen e një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet komunës, shkollave profesionale dhe bizneseve lokale

I nderuari z. Duraku dhe i nderuari z. Geci,

Në cilësinë time si anëtar i Kuvendit Komunal të Skendrajt, kam kënaqësinë të paraqes këtë propozim për inicimin e një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe bizneseve lokale.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është angazhimi i nxënësve të shkollave profesionale në kuadër të praktikës mësimore, në prodhimin dhe rregullimin e elementeve të ndryshme për hapësirat publike të komunës, si: shporta për mbeturina, ulëse për parqe dhe clemente të tjera funksionale për rregullimin e parqeve dhe ambienteve publike.

Gjithashtu, jam i informuar se Drejtoria e Arsimit, ndër vite, ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private për realizimin e praktikës profesionale të nxënësve në profile të ndryshme, gjë që paraqet një bazë të mirë për zgjerimin e këtij bashkëpunimi edhe në këtë drejtim.

Sipas këtij modeli, bizneset lokale do të kontribuonin me sigurimin e lëndës së parë, ndërsa nxënësit do të realizonin produktet në kuadër të praktikës profesionale. Njëkohësisht, bizneset kontribuese do të mund të përfitojnë promovim përmes vendosjes së elementeve identifikuese apo reklamuese në produktet e realizuara.

Përfitimet nga realizimi i këtij bashkëpunimi do të ishin:

1. Nxënësit e shkollave profesionale fitojnë përvojë praktike dhe aftësi profesionale të dobishme për tregun e punës.
2. Komuna përmirëson dhe pasuron hapësirat publike me elemente funksionale për qytetarët.
3. Bizneset lokale promovohen dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e komunitetit.
4. Forcohet bashkëpunimi ndërmjet arsimit profesional dhe sektorit privat, duke krijuar një model të qëndrueshëm për të ardhmen.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij bashkëpunimi, propozoj që Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, në koordinim me bizneset lokale, të shqyrtojnë mundësinë e hartimit dhe implementimit të këtij memorandumi bashkëpunimi.

**Me respekt,
Burim Veliu
Anëtar i Kuvendit Komunal, Skenderaj (PDK)**